

Emër Mbiemër **FLORESHA DADO**  
Datëlindje **24.03.1947**  
Vendlindje **Vlorë**  
Viti i zgjedhjes **2008**  
Seksioni **Shkencat Shoqërore dhe Albanologjike**  
Gjuhët anglisht, (italisht, frengjisht, rusesht-lexim)



### **Kontakt**

---

Adresa: Rruga "Skënder Kosturi", Pall. Tani 5, Ap.3/2 Tiranë

Telefon: 069 24 70 112

Email: [flora.dado@yahoo.com](mailto:flora.dado@yahoo.com)

Faqe zyrtare: [www.akad.gov.al](http://www.akad.gov.al)

---

### **Cv e shkurtër**

Studiuese e letërsisë shqiptare, specialiste e *teorisë së letërsisë* në Departamentin e Letërsisë të Universitetit të Tiranës.

Studimet e larta për gjuhë dhe letërsi shqipe i përfundoi në Fakultetin e Historisë dhe të Filologjisë të Universitetit të Tiranës (1968)

Në periudhën 1970-1982 ishte bashkëpunëtore shkencore në Sektorin e letërsisë shqiptare pranë Institutit të Gjuhësisë e Letërsisë të Akademisë së Shkencave.

Nga viti 1982 e në vazhdim (pedagoge e brendshme dhe sot e jashtme në masterin shkencor), pranë Departamentit të Letërsisë të Universitetit të Tiranës.

Në vitin 1981 mori gradën shkencore "Kandidat i shkencave", e konvertuar në vitin 1994 me gradën "Doktor".

Në vitin 1986 ka marrë titullin shkencor "Docent".

Në vitin 1995 ka marrë titullin "Profesor".

Në vitin 2008 ka marrë titullin "Akademike".

Ka qenë përgjegjëse e Departamentit të Letërsisë (1989-1993)

Dekane e Fakultetit të Historisë e Filologjisë (1992-1993)

Zv. rektore e Universitetit të Tiranës (2000-2003)

Themeluese dhe drejtore e shkollës pasuniversitare "Studime evropiane" (2001-2003)

Anëtare e Komisionit të Lartë të Kualifikimit Shkencor pranë MASH (1989-2005)

Në periudhën 2015-2020 ka qenë kryetare e Seksionit të Shkencave Shoqërore dhe Albanologjike në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë.

Me kontribute të vazhdueshme në senate, këshilla shkencore dhe redaksi të revistave shkencore në Fakultetin e Historisë e të Filologjisë dhe në Institutin e Gjuhësisë e Letërsisë.

Ka mbajtur kurse pasuniversitare të *Teorisë së letërsisë* dhe të *Kritikës letrare* në Fakultetin e Historisë dhe të Filologjisë dhe në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja.

Ka mbajtur leksione pasuniversitare në Universitetin e Prishtinës dhe ligjërata në Universitetin e Tetovës.

#### AUTORE E DISA VEPRAVE :

2020 – “Postmodernizmi-poetikë e antirregullit”, (*monografi shkencore*), Akademia e Shkencave, 440 faqe

2019 – “Identifikimi i poetikave në plan teorik dhe historiko-letrar” (përmbledhje studimesh ) *Onufri*, 492 faqe

2016 – “Lexuesi ‘në kurth’: Eseistika e Kadaresë” (*monografi shkencore*), *Onufri*, 328 faqe

2012 – “Andon Zako Çajupi- jeta politike dhe vepra letrare” (*monografi shkencore*), rikonceptim i interpretimit të veprës së plotë, *Bota Shqiptare*, 305 faqe

2010 - “Letërsi e painterpretuar” (*monografi shkencore*), *Bota Shqiptare*, 277 faqe

2009 - “Sfida teorike të historiografisë letrare”, (*monografi shkencore*), *Bota Shqiptare*, 368 faqe

2006 - “Intuitë dhe Vetëdije Krijuese” (përmbledhje studimesh mbi letërsinë e traditës dhe bashkëkohore), *Onufri*, 382 faqe

1999 - “Teoria e veprës letrare-Poetika” (studim teorik), *Toena*, 325 faqe

1997- “Proza nëpër teknikat poetike” (studim teorik), *Toena*, 243 faqe

1983 - Monografia shkencore “Jeta dhe vepra e A.Z.Çajupit”, botim i Akademisë së Shkencave, 282 faqe

1983- Botimi i veprës së plotë të Çajupit, në tre vëllime, *Naim Frashëri*

- Autore dhe bashkautore në tekste dhe leksione nga fusha e teorisë së letërsisë.

- Udhëheqëse shkencore e një numri doktoraturash dhe masterish në fushën e studimeve letrare.
- Autore e shumë referimeve në konferenca shkencore brenda e jashtë vendit.
- Hartuese e një numri të madh artikujsh (mbi 100), të botuar në organe shkencore dhe kulturore.